



QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË

Trendet e Perceptimeve të Publikut për Politikën e Jashtme
dhe Dialogun me Serbinë

Periudha: 2013 – 2016





QKSS
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË

Trendet e Perceptimeve të Publikut për Politikën e Jashtme
dhe Dialogun me Serbinë

Periudha: 2013 – 2016

Botues: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Interpretimi i të dhënave: Donika Emini

Redaktimi i brendshëm: Dr. Florian Qehaja

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen me shkrim të botuesit. Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i të gjitha materialeve që botohen nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) pa lejen me shkrim të QKSS-s. Ju lutem kontaktoni në: info@qkss.org ose +381 38 221 420.

Perceptimet e paraqitura në këtë raport janë përmbledhje e përgjigjeve të nxjerra nga të anketuarit ku ata demonstronjë mënyrën se si ata i shohin institucionet e përfshira në studim. Ato në asnjë mënyrë nuk paraqesin ndonjë vlerësim përfundimtar të punës së institucioneve të matura. Megjithatë rezultatet e tilla gjithësi shërbejnë si instrument për adresimin e mangësive të mundshme sa i përket performancës institucionale, por edhe si tregues i funksionimit të komunikimit të institucioneve në fjalë me qytetarët.

Pikëpamjet e paraqitura në këtë raport janë perceptime të të anketuarve dhe jo-domosdo korrespondojnë me botëkuptimet e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë. Gjithashtu, pikëpamjet e shprehura në këtë raport në asnjë mënyrë nuk përbëjnë pikëpamjet e fondacionit National Endowment for Democracy (NED).

MIRËNJOHJE

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) ju shpreh mirënjohje të veçanta ekipit hulumtues në terren për kontributin e tyre të çmuar. Ekipi hulumtues i Barometrit Kosovar të Sigurisë për vitin 2016 përbëhej nga:

Koordinatorët e Programit dhe Metodologë:

Mentor Vrajolli dhe Tringa Naka

Trajnerë të hulumtimit në terren:

Donika Emini dhe Skender Perteshi

Koordinatorët e hulumtimit në terren:

Skender Perteshi, Donika Emini, Vesë Kelmendi, Sofije Kryeziu dhe Leonora Aliu

Zyrtarët për futjen e të dhënave:

Bardha Maxhuni, Rudinë Jakupi dhe Arife Muji

Ekipi hulumtues në terrenit:

Argjira Kameri, Albinë Bricori, Andi Emini, Arian Mavriqi, Adnan Krueziu, Bardh Krasniqi, Blerta Krasniqi, Blerinë Ukshini, Dardan Naka, Diellza Kosumi, Doruntina Shabani, Donat Breznica, Erna Buçaj, Elona Krasniqi, Flandra Osmani, Florent Gashi, Gojart Jashari, Gëzim Stavileci, Hafize Jashari, Kushtrim Mustafa, Marigona Dubovci, Rina Koleci, Rita Nushi, Taulant Boshnjaku, Valëza Mjeku, Valton Ismajli dhe Valmire Imeri.

Shënim: Ky raport në formën e tij origjinale është shkruar në gjuhën angleze

PËRMBAJTJA

MIRËNJOHJE.....	5
ÇKA ËSHTË BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË?	8
Kujt i drejtohem me këtë edicion special?	8
Ndikimi	8
Metodologjia	9
BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË (BKS) TRENDET E PERCEPTIMEVE NGA 2013 DERI NË 2016: GJETJET KRYESORE	10
HYRJE	12
KAPITULLI I.....	13
1. TRENDET E PERCEPTIMEVE TË PUBLIKUT NDAJ SHTETEVE RELEVANTE RAJONALE.....	13
1.1. Trendet e Perceptimeve të Publikut ndaj Shqipërisë dhe Serbisë	13
1.2. Trendet e Perceptimit Publik ndaj Maqedonisë dhe Mali të Zi	16
KAPITULLI II	19
2. TRENDET E PERCEPTIMEVE TË PUBLIKUT NDAJ FUQIVE TË MËDHA	19
2.1. Trendet e Perceptimeve të Publikut ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Gjermanisë	19
2.2. Trendet e Perceptimeve të Publikut ndaj Mbretërisë së Bashkuar, Francës dhe Turqisë	21
2.3. Trendet e Perceptimeve të Publikut ndaj Rusisë dhe Kinës	23
KAPITULLI III	25
3. TRENDET E PERCEPTIMEVE TË PUBLIKUT NDAJ ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE DHE PERSPEKTIVA EURO-ATLANTIKE E KOSOVËS	25
3.1. Trendet e Perceptimeve të Publikut ndaj ndaj anëtarësimit të Kosovës në BE	25
3.2. Trendet e Perceptimeve të Publikut ndaj Anëtarësimit në NATO	26
KAPITULLI IV	28
4.1. TRENDET E PERCEPTIMEVE TË PUBLIKUT NDAJ DIALOGUT POLITIK ME SERBINË.....	28
4.2. (Mos) arritja e normalizimit	28
4.3. Dialogu Politik në mes të Kosovës dhe Serbisë: Kush është fituesi?	30
4.4. Trendet e Perceptimeve të publikut për krijimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe	32

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Trendet e Perceptimeve të Publikut ndaj Shqipërisë dhe Serbisë	15
Figura 2: Trendet e Perceptimeve të Publikut ndaj Maqedonisë dhe Malit të Zi	17
Figura 3: Trendet e Perceptimeve Publike ndaj Kroacisë dhe Bosnjë e Hercegovinës	18
Figura 4: Trendet e Perceptimeve Publike ndaj ShBA-së dhe Gjermanisë	20
Figure 5: Trendet e Perceptimeve të Publikut ndaj Mbretërisë së Bashkuar, Francës dhe Truqisë	22
Figura 6: Trendet e Perceptimeve të Publikut ndaj Rusisë dhe Kinës	24
Figure 7: Trendet e Perceptimeve të Publikut ndaj anëtarësimit të Kosovës në BE	26
Figure 8: Trendet e Perceptimeve të Publikut ndaj anëtarësimit në NATO	27
Figura 9: Trendet e Perceptimeve të Publikut ndaj Normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë	30
Figura 10: Trendet e Perceptimeve të Publikut për rezultatit të Dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë	32
Figura 11: Trendet e Perceptimeve të publikut për krijimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe	33

ÇKA ËSHTË BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË?

Barometri Kosovar i Sigurisë (BKS) është program i veçantë i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), i cili ka për qëllim që të dal me një publikim të përvitshëm mbi perceptimet e qytetarëve. Më konkretisht, qëllimi kryesor i BKS-s është që ta masë perceptimin e opinionit publik për institucionet e sigurisë dhe të drejtësisë. Njëkohësisht, KSB mat perceptimin publik lidhur me kërcënimet e brendshme dhe të jashtme për Kosovën, si dhe politikën e jashtme të Kosovës dhe Dialogut me Serbinë.

BKS-ja është ndër nismat e para dhe më të mëdha të iniciuara, realizuara dhe publikuara nga një organizatë vendore. Ajo që e veçon KSB-në, QKSS-ja nuk ka kurrfarë kufizimi politik sa i përket komunikimit të gjetjeve dhe të mesazheve që mëton t'i përçojë. Për fund, BKS-ja është unike sa i përket qasjes metodologjike, duke i integruar metodat kuantitative dhe kualitative me synim të ofrimit të rezultateve sa më reale sa i përket perceptimit të publikut karshi çështjeve që lidhen me siguri.

Kujt i drejtohem me këtë edicion special?

BKS-ja i drejtohet akterëve të ndryshme, të cilat janë të interesuar t'i përcjellin trendet e opinionit publik në fushën e sigurisë dhe të drejtësisë. Rrjedhimisht, ndër të tjera i drejtohet hartuesve të politikave në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor, organizatave ndërkombëtare në Kosovë dhe selive të tyre, organizatave vendore dhe ndërkombëtare të shoqërisë civile, qarqeve akademike dhe mediave.

Ky edicion special i BKS-së synon një shumëllojshmëri të gjerë të palëve të interesuara për të ndjekur perceptimin e opinionit publik në Kosovë kundrejt partnerëve kyç strategjik në nivelin rajonal dhe ndërkombëtar. Më konkretisht ky edicion i drejtohet një grupi audience të interesuar për të ndjekur trendet e opinionit publik në Kosovë, duke u përqendruar në politikën e jashtme të Kosovës, bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe në dialogun me Serbinë. Në përgjithësi, BKS-ja targeton hartuesit e politikave; praninë e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë; organizatat lokale, rajonale dhe ndërkombëtare të shoqërisë civile; akademitë, si dhe mediat.

Ndikimi

Ndikimi i BKS-s pritet që të shumëfishohet në një periudhë afatmesme për një varg arsyesh, siç janë (a) besueshmëria e QKSS-s si një organizatë politike, jo partiake, dhe e pavarur; (b) përvoja e dëshmuar e QKSS-s në zbatimin e metodave të duhura shkencore gjatë hulumtimeve të veta; (c) rëndësia e pronësisë vendore; dhe (d) kapacitetet

profesionale që i ka QKSS-ja. Në gjitha edicionet e mëparshme, BKS-ja i ka përmbushur synimet e lartpërmendura.

Metodologjia

Ky edicion special i BKS-së është një përmbledhje e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve të sigurisë dhe të drejtësisë. Në veçanti, e ka matur perceptimin e publikut kundrejt politikës së Jashtme të Kosovës, partnerëve strategjik rajonal dhe ndërkombëtarë, dhe dialogut me Serbinë.

Për më tepër, i ka mundësuar interpretuesit të të dhënave të dekonstruktojë thellë perceptimet e qytetarëve. Për më tepër, ky edicion ofron të dhëna cilësorë/përmbajtësore të mbledhura përgjatë periudhës: prej 2013 deri në 2016, kështu duke ofruar trende të perceptimeve kundrejt politikës së jashtme të Kosovës.

Interpretimi reflekton mbi grupin e faktorëve politik dhe shoqërorë të cilat kanë ndikuar në formësimin e mendimit të të anketuarve. Dekonstruksioni i opinionit është i bazuar në përfshirjen e drejtpërdrejtë të interpretuesit të të dhënave në intervistat e drejtpërdrejta me të anketuarit. Gjithashtu, grupet e fokusit me hulumtuesit në terren të cilët kanë mbështetur përpjekjet e ekipit të QKSS në dekonstruktimin dhe analizimin e mëtejshëm të opinioneve që përmban ky edicion special. Ky edicion thekson perceptimet e qytetarëve ndaj shteteve rajonale dhe ndërkombëtare, partnerët politik dhe strategjik të Kosovë, si dhe dialogun me Serbinë - duke qenë njëri ndër proceset më të debatueshme dhe të tejzgjatura në politikën e jashtme të Kosovës.

Përgjigjet ndaj pyetësorit të BKS-s janë marrë përmes intervistave në terren, të cilat janë realizuar anëmbanë Kosovës. Shumica e pyetjeve kanë qenë të llojit të mbyllur, dhe përgjigja mund të jepej sipas modelit të Likert-it prej pesë shkallëve. Disa pyetje ishin të hapura, të cilat ua mundësonin të anketuarve ta jepnin mendimin e tyre pa u kufizuar në opsione të përcaktuara më parë. Përcaktimi i mostrës, pilotimi dhe intervistat u zhvilluan prej ekipit të QKSS-s, i cili përbëhej prej 27 hulumtuesve të terrenit. Mostra gjithëpërfshirëse në nivel vendi, prej të cilës është realizuar hulumtimi, përbëhej prej 1,093 amvisërive, duke u pasuar prej një mostre përfaqësuese të popullsisë së moshës mbi 18 vjeçare në Kosovë. Ndarja sipas përkatësisë etnike e pjesëmarrësve të intervistuar ishte si vijon: 86.9 për qind shqiptarë të Kosovës, 7.0 për qind serbë të Kosovës, dhe 6.1 për qind pjesëtarë të bashkësive të tjera (1.4 për qind turq, 0.6 për qind boshnjakë, 0.9 për qind romë, ashkali, dhe egjiptianë, dhe të tjerët janë goranë, kroatë dhe malazezë).

Korniza e mostrës është e bazuar në kodin zonal të telefonisë, dhe si rrjedhojë përbëhej prej 7 rajoneve: Ferizaj, Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Prishtinë dhe Prizren. Faza e parë e grupimit gjeografik u bazua në raportin e regjistrimit civil në Kosovë të

vitit 2011, ndërsa në fazën e dytë grupimi i mostrave është bazuar në komunat përkatëse duke përfshirë këtu edhe shtresëzimin rurale/urbane, si dhe gjithashtu duke marrë për bazë numrin e amvisërive. Ndërsa në fazën e fundit grupimi i mostrës është bërë duke marrë për bazë metodën e rastit, respektivisht duke e përdorur metodën e ditëlindjes më të përafërt me ditën e mbajtjes së anketës. Përcaktimi i mostrës sipas rastit siguron që secili banor i Kosovës të ketë gjasë të barabartë që të përzgjidhet për intervistë. Duke e pasur parasysh mostrën e shfrytëzuar për këtë studim, mund të themi në përgjithësi se rezultatet e hulumtimit e pasqyrojnë trendin e qëndrimeve dhe të perceptimeve të krejt popullatës së moshës së rritur të Kosovës. Si rrjedhojë, margjina e gabimit është 3 për qind ndërsa intervali i besimit është mbi 95 për qind.

Vlen të theksohet se para fillimit me pjesën e hulumtimit në terren, respektivisht në mesin e muajit shtator të vitit 2016, ekipi hulumtues fillimisht kishte zhvilluar intervista pilotuese me qëllim që të testimit të realizueshmërisë së pyetësorit. Pilotimi kishte rezultuar të jetë i suksesshëm, pa hasur në ndonjë problem me pyetjet e bëra ndaj të intervistuarit, duke shërbyer kështu si dritë e gjelbër për fillimin e anketimit. Ndërkohë, të gjitha intervistat e këtij edicioni të KSB u realizuan gjatë dy javëve të para të muajit tetor 2016. Përpunimi dhe analizimi i të dhënave u realizua me softuerin SPSS.

Perceptimet e paraqitura në këtë raport janë përmbledhje e informatave të marra prej të anketuarve, dhe e paraqesin perceptimin e personave të anketuar ndaj institucioneve të përfshira në studim. Andaj, raporti nuk është ndonjë vlerësim përfundimtar i cilësisë së punës në institucionet që janë subjekt i këtij studimi. Qëllimi i QKSS-s, me botimin e këtij raporti, është që t'i interpretojë perceptimet, pra të shtjelloj atë se "cili është qëndrimi" i qytetarëve të Kosovës në lidhje me sferave e identifikuara me pyetësorit. Ekipi i QKSS-s nuk merr përgjegjësi për rezultatin e të dhënave të grumbulluara, posaçërisht nëse ato kurdoherë nxitin ndonjë reagim të palëve të caktuara. Ndërkohë, për çfarëdo shqetësimi të ngritur ekipi mbetet gjithnjë i gatshëm që ta bëjë transparent tërë procesin e anketimit dhe metodologjinë e përdorur.

BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË (BKS) TRENDET E PERCEPTIMEVE NGA 2013 DERI NË 2016: GJETJET KRYESORE

- Trendet e përgjithshme përgjatë tre viteve tregojnë se të anketuarit ndajnë perceptime të ndryshme dhe mjaft të dallueshme ndaj Shqipërisë dhe Serbisë. Gjetjet tregojnë se Shqipëria perceptohet si shteti më aleat ndaj Kosovës nga mbi 90.0 për qind e të anketuarve. Serbia në anën tjetër është listuar si shteti më armiqësor ndaj Kosovës nga 90.0 për qind e të anketuarve. Ndërsa pozicionimi ndaj Shqipërisë dhe Serbisë është shumë i qartë, perceptime të

përziera ka për dy vendet tjera fqinje të Kosovës, respektivisht, Mali i Zi dhe Maqedonia. Pothuajse gjysma e të anketuarve perceptojnë këto dy vende si neutrale ndaj Kosovës.

- Shtetet perëndimore, kryesisht SHBA dhe Gjermania mbeten aleatet më të mëdha të Kosovës në arenën ndërkombëtare, këto shtete gjithashtu shihen si partnerët kryesorë në procesin e shtetndërtimit të Kosovës. Nga ana tjetër, Turqia është duke u perceptuar si një aleat i ri i mundshëm, nga një pjesë e madhe e kosovarëve të cilët besojnë që Kosova duhet të forcojë partneritetin edhe më tej me Turqinë. Kroacia është listuar së bashku me aleatët potencial strategjik për Kosovën ngaqë është perceptuar si shumë pozitiv nga respondentët. Kroacia është pare si aleat ushtarak dhe model për Kosovën në rrugën e saj drejt BE-së.
- Qytetarët e Kosovës ndajnë perceptime pozitive në raport me procesin e integritimit në BE dhe NATO duke treguar qartazi një nivel të madh të entuziazmit dhe gatishmërisë për t'u bashkuar me strukturat e tilla. Nga ana tjetër, një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve besojnë se BE-ja nuk ka një qasje konstruktive ndaj Kosovës. Një ekzaminim i afërt i trendeve përgjatë tre viteve të fundit tregon se kjo qasje pozitive është rritur atëherë kur u dha opinioni pozitiv për liberalizimin e vizave për Kosovën, edhe pse procesi ka stagnuar që atëherë. Në këtë drejtim, perceptimi i palëkundur ndaj BE-së dëshmon se frustrimi për këtë dështim i është drejtuar më shumë qeverisë dhe opozitës në Kosovë, më tepër për shkak të dështimit për të arritur konsensus për çështjen e demarkacionit me Malin e Zi.
- Gati një dekadë pas lansimit të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, si në nivelin teknik dhe politik, ky proces i stërzgatur dhe i vështirë ka nxitur shumë debate të nxehta në mesin e elitës politike dhe qytetarëve të Kosovës. Në këtë drejtim, pothuajse gjysma e të anketuarve besojnë se Serbia po përfiton më shumë se Kosova prej këtij procesi duke iu referuar proceseve të integritimit në BE për të dy shtetet. Ngjashëm, pjesa më e madhe e të anketuarve besojnë se dialogu po dështon për të arritur qëllimin gjithëpërfshirës - normalizimin e vërtetë të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë.
- Rezultatet përgjatë tre viteve tregojnë se mendimet ndaj çështjes që ka nxitur debat të nxehtë në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi, krijimi i Asociacionit të Komunave me shumicë serbe, është perceptuar negativisht nga një pjesë e madhe e të anketuarve. Një numër i madh i të anketuarve, ose mbi 80.0 për qind e tyre kanë treguar qëndrim negativ sa i përket krijimit të Asociacionit të Komunave me shumicë Serbe duke e parë atë si shumë të dëmshme dhe të dëmshme për Kosovën.

HYRJE

Kapitulli mbi bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar ka qenë një pjesë integrale e BKS-së që nga fillet e këtij programi. QKSS ka konsideruar të nevojshme të lansojë edicionin special dhe të vazhdojë punën duke identifikuar tendencat në perceptimet e publikut drejt shteteve më relevante dhe organizatave ndërkombëtare, të cilat janë gjithashtu një çështje me interes për Kosovën. Tendencat e vazhdueshme të krijimit të marrëdhënieve bilaterale dhe multilaterale, marrëdhëniet me vendet fqinje, si dhe ngjarjet që po ndodhin në dialogun Kosovë-Serbi mbeten çështjet kryesore të analizës në këtë edicion.

Ky edicion, gjithashtu, do të manifestojë perceptimet e qytetarëve për akterët rajonal dhe ndërkombëtarë, përfshirë pozicionimin kundrejt vendeve fqinje. Krahasuar me dy edicionet e para, ky publikim do të sjellë një listë të re të çështjeve që kanë të bëjnë me dialogun politik me Serbinë, veçanërisht marrëveshjet që janë arritur në këtë proces.

Për më shumë, ky edicioni special i trajton dimensionet e mëposhtme:

- Trendet e Perceptimeve të publikut ndaj akterëve relevant rajonal dhe ndërkombëtare;
- Trendet e Perceptimeve të publikut ndaj organizatave ndërkombëtare, proceset e integritetit euro-atlantik dhe partneriteteve të tjera të mundshme strategjike;
- Trendet e Perceptimeve të publikut kundrejt dialogut politik me Serbinë

KAPITULLI I

1. TRENDET E PERCEPTIMEVE TË PUBLIKUT NDAJ SHTETEVE RELEVANTE RAJONALE

Lista e shteteve rajonale që janë vlerësuar në sondazhin e QKSS-së ka mbetur e pandryshuar nga edicionet e mëparshme. Kjo listë përfshin shtetet fqinje të Kosovës, të tilla si Shqipëria, Serbia, Maqedonia dhe Mali i Zi. Megjithatë, duke pasur parasysh tendencat e fundit të zhvillimit të marrëdhënieve bilaterale dhe multilaterale në rajon, ekipi i QKSS konsideroi të rëndësishme të bëjë matjen e perceptimeve ndaj Kroacisë - një vend gjithnjë në rritje të mbështetjes në procesin e shtetndërtimit në Kosovë, dhe Bosnja e Hercegovina – që përfaqëson shtetin e vetëm në Ballkanin perëndimor që është rreshtuar krahas Serbisë në mosvendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Kosovën.

Të anketuarit janë pyetur të vlerësojnë marrëdhëniet dhe qëndrimin e këtyre vendeve ndaj Kosovës duke filluar nga shkallët negative të tilla si shumë armiqësor, armiqësor, duke vazhduar me shkallë neutrale, dhe shkallët pozitive me miqësore dhe shumë miqësore. Është e një rëndësie të veçantë të përmendet që kur u pyetën në lidhje me shtetet e rajonit të anketuarit kanë formësuar mendimin bazuar në përvojën e tyre personale dhe opinioneve të krijuara me kalimin e kohës, ndërsa e njëjta nuk vlen për shtetet e tjera jo-rajonale, siç do të shtjellohet më tej në seksionin tjetër. Shtetet janë të grupuara në një mënyrë që të pasqyrojë gjetjet kryesore të këtij raporti, duke filluar me shtetet që kanë marrëdhënie më të forta dhe intense me Kosovën, si Shqipëria dhe Serbia, dhe vazhdon me dy vendet e tjera fqinje, për të cilat të anketuarit duket të ketë mendime neutrale dhe dy vendet që janë bashkuar BKS-së vetëm në pyetësinë e vitit 2016.

1.1. Trendet e Perceptimeve të Publikut ndaj Shqipërisë dhe Serbisë

Trendet e rezultateve të BKS-së tregojnë se në përgjithësi respondentët ndajnë perceptime të ndryshme dhe mjaft të dallueshme ndaj Shqipërisë dhe Serbisë, si dy prej katër vendeve fqinje. Siç tregohet në Figurën 1, përgjatë tre viteve të kaluara, mbi 90.0 për qind e të anketuarve ka ndarë perceptim kryesisht pozitiv ndaj Shqipërisë. Në të kundërtën, dhe gjithsesi e pritshme, perceptimet ndaj Serbisë mbeten negative me disa lëvizje të lehta përgjatë 90.0 përqindëshit, me disa që edhe e konsiderojnë Serbinë si kërcënimi kryesorë i jashtëm ngaj Kosovës.

Sa i përket, rezultateve të BKS-së nga 2013 deri në 2016 e ri-konfirmojmë perceptimin e përgjithshëm që Shqipëria në mesin e të gjitha vendeve në rajon, është aleati më i madh i Kosovës. Duke u konsideruar si vendi më mik ndaj Kosovës nga më shumë se 90.0 për qind e respondentëve. Argumentet kryesore që qëndrojnë prapa pozicionimit pozitiv ndaj Shqipërisë – të cilat nxiten – kryesisht nga vlerat e përbashkëta kombëtare, tradicionale, historike dhe kulturore. Për më tepër, rritja e mobilitetit në mes të qytetarëve nga Kosova dhe Shqipëria mund të thuhet se ka nxitur një opinion të bazuar vetëm në eksperiencën personale, por edhe një perceptim të bazuar në sentimentin etnik. Si pasojë, perceptimet pozitive nuk kanë ngjarë të jenë të ngjashme në mes të respondentëve Serb and grupeve të tjera minoritare që jetojnë në Kosovë, të cilët vendosën të mbesin neutral në pikëpamjet e tyre ndaj Shqipërisë, me disa edhe që ndanë perceptime negative.

Kur u është kërkuar që të vlerësojnë qasjen e Shqipërisë ndaj Kosovës, hulumtimi kualitativ me hulumtuesit në terren ka treguar që përveç faktoreve të sipër-përmendur, respondentët gjithashtu kanë bazuar perceptimet e tyre pozitive në aktivitetet e përbashkëta kulturore dhe eventet në mes të elitave kulturore nga të dy vendet. Edhe pse, një ekzaminim më i afërt i rezultateve tregon që perceptimet janë të bazuara kryesisht në eventet politike të cilat kanë ndodhur në vitet e kaluara. Përderisa, gjatë vitit 2014, Shqipëria ishte duke e konsoliduar qeverinë e re të përbërë nga një parti e re politike – ndërrimi i liderit politik – ka pasur një impakt të konsiderueshëm në perceptimet dhe pritshmëritë nga Shqipëria, kështu duke rezultuar në 90.7 të respondentëve që ndajnë mendim pozitiv. Megjithatë, rritja e lehtë në vitin 2015 me rreth 64.6 për qind që kanë listuar Shqipërinë si shumë pozitive, tregon që qasja proaktive e liderit të ri Shqiptar në politikën e jashtme, veçanërisht në raport me pavarësinë e Kosovës, ka rritur opinionin pozitiv. Roli prej lideri i Shqipërisë, diskursi politik i liderit Shqiptar duke treguar mbështetje në iniciativat e shumta rajonale dhe ndërkombëtare dhe mbajtja e një qëndrimi më të fortë në mbështetje të pavarësisë së Kosovës në arenën ndërkombëtare është listuar si njëri ndër faktorët kyç prapa qasjes pozitive ndaj Shqipërisë. Gjithashtu, e shoqëruar me ndeshjen e futbollit kundër Serbisë, një periudhë që shënoi një rritje substanciale të identitetit nacional në mesin e Shqiptarëve, jo vetëm në Kosovë por edhe të atyre që jetojnë në të gjithë rajonin e Ballkanit.

Kjo qasje pozitive ka shënuar një ulje të lehtë në vitin 2016, me 90.9 për qind të qytetarëve që ndajnë perceptime pozitive ndaj Shqipërisë. Kjo ulje me gati 4 për qind është ndikuar shumë nga debatet mbi komb-ndërtimin në Kosovë, si e tillë, 2016 shënoi një debat shumë të gjerë mbi identitetin Shqiptar dhe Kosovën nga të dyja palët. Përveç kësaj, roli prej lideri i Shqipërisë në rajon, dhe “ri-vendosja e marrëdhënieve politike me Serbinë” ka nxitur skepticizëm në mesin e Kosovarëve. Opinioni publik në Kosovë ka pasur frikë nga “de-faktorizimi” i Kosovës e cila ngadalë është futur nën hijen e marrëdhënieve bilaterale në mes të Shqipërisë dhe Serbisë.

Përderisa perceptimi pozitiv ndaj Shqipërisë vazhdon të shënojë rritje, e kundërta duket të jetë rasti ndaj Serbisë. Siç paraqitet në figurën 1, kur janë pyetur për qasjen e Serbisë


ndaj Kosovës, rreth 90.0 përqind e respondentëve qartazi janë deklaruar negativisht. Rezultatet e nxjerrura në tre vitet e kaluara tregojnë një trend të perceptimeve negative – veçanërisht në mes e respondentëve Shqiptar të Kosovës – ndaj Serbisë. Në sytë e respondentëve Shqiptar, Serbia vazhdon të perceptohet si shtet shumë armiqësorë.

Është evidente që perceptimi negativ ndaj Serbisë është ndikuar jo vetëm nga kujtesa historike e konfliktit dhe shtypjes dhe luftës së vitit 1999, por edhe të hezitimit të Serbisë për të zbutur qasjen ndaj Kosovës – respektivisht të rolit destruktiv ndaj pavarësisë, dhe përpjekjet e vazhdueshme për të stagnuar procesin e shtet-ndërtimit në Kosovë. Respondentët jo vetëm që kanë ndarë perceptime negative ndaj Serbisë, por rezultatet e BKS në tre vitet e kaluara tregojnë që Serbia është listuar si kërcënimi më i madh i jashtëm për Kosovën dhe qytetarët e saj, nga rreth 70.0 për qind e respondentëve¹.

Dështimi për të dëshmuar rezultate të prekshme nga dialogu Kosovë-Serbi, qasja e pandryshuar e Serbisë ndaj shtetësisë së Kosovës, dhe rritjes së pakënaqësisë me marrëveshjet e arritura në mes të Kosovës dhe Serbisë, veçanërisht ai për themelimin e Asociacionit të Komunave Serbe ka ushqyer më tej pesimizmin ndaj Serbisë.

Një përqindje e vogël e respondentëve, rreth 8.0 përqind në mesatare mendojnë se qasja e Serbisë ndaj Kosovës është pozitive. Në këtë drejtim, respondentët Serb që jetojnë në Kosovë, përfshirë këtu edhe ata në pjesën veriore të Kosovës kanë dhënë mendimin e tyre për qasjen e Serbisë ndaj Kosovës, duke e parë prezencën e Serbisë në zonat e banuara nga minoriteti Serb si pozitiv dhe të nevojshëm. Kjo, megjithatë, reflekton një ndarje të qartë në mes të Serbisë dhe Kosovës, si e tillë mund të konsiderohet si pranim gradual i realitetit faktit të ekzistencës së Kosovës si shtet, dhe realitetin e tyre që jetojnë në Kosovë.

Figura 1: Trendet e Perceptimeve të Publikut ndaj Shqipërisë dhe Serbisë



¹ Për rezultate të detajuara ju lutem të referoheni tek publikimet e mëparshme të BKS-së në faqen zyrtare të QKSS: www.qkss.org ose të kontaktoni koordinatoren e programit nëse jeni të interesuar të dini më shumë për metodologjinë dhe databazën.

1.2. Trendet e Perceptimit Publik ndaj Maqedonisë dhe Mali të Zi

Përderisa respondentët duket se ndajnë perceptime të qarta ndaj Shqipërisë dhe Serbisë, opinionet e mledhura përgjatë tre viteve të kaluara mbi qasjen e Maqedonisë dhe Malit të Zi ndaj Kosovës duket se janë kryesisht neutrale. Qartazi, perceptimet ndaj këtyre dy vendeve janë mjaft të përziera, kështu duke treguar një tendencë të i pozicionojnë ato në territor neutral.

Qasja e përgjithshme pozitive ndaj Maqedonisë dhe Malit të Zi është formuar në bazë të vendimit të qeverive të këtyre vendeve për të njohur pavarësinë e Kosovës menjëherë pas deklarimit, kështu duke u rreshtuar në mesin e aleatëve më të mëdhenj të Kosovës, dhe qartazi duke treguar ndarje ndaj qasjes së Serbisë. Edhe pse, ekziston një varg i gjatë i faktorëve që i kontribuojnë atyre që ndajnë një qasje skeptike ndaj Maqedonisë dhe Malit të Zi.

Në rastin e Maqedonisë, mesatarisht rezultatet në tre vitet e fundit tregojnë një rritje të perceptimit pozitiv dhe ulje të atyre që e perceptojnë Maqedoninë si vend armik, një rritje e lehtë është shënuar në mesin e atyre që e kanë listuar Maqedoninë si neutrale. Përqindja e atyre që e perceptojnë Maqedoninë si vend mik ka shënuar ngritje me rreth 2 për qind për çdo vit, prej 31.5 për qind në vitin 2014 në 35.3 për qind në vitin 2016. Bashkëpunimi ekonomik dhe rritja e mobilitetit, më shumë e Kosovarëve drejt Maqedonisë për qëllime turistike ka pasur një ndikim shumë të madh në qasjen pozitive. Në tre vitet e fundit, përsëherë, Maqedonia ka qenë adresa e parë për Kosovarët në kërkim të shërbimeve shëndetësore, si dhe rritja e numrit të Kosovarëve që e përdorin aeroportin ndërkombëtar të Shkupit për shkak të çmimeve konkurruese. Përveç kësaj, hulumtuesit në terren kanë vërejtur aftësinë e respondentëve për të bërë dallimin në mes të shtetit të Maqedonisë, me komunitetin Shqiptar që jeton në Maqedoni, qasja pozitive ishte gjithashtu e shtyer nga lidhjet e ngushta që Shqiptarët nga Kosova kanë me komunitetin Shqiptar në Maqedoni.

Shumica e respondentëve kanë argumentuar se ka një lëvizje të lehtë pozitive duke treguar një rritje të tolerancës ndër-etnike në Maqedoni, kryesisht e shtyer nga protestat masive që tregonin unitetin e të gjitha grupeve etnike kundër qeverisë. Një pjesë e madhe e respondentëve – 40.0 për qind në mesatare kanë ndarë mendime negative ose janë treguar të rezervuar kur janë pyetur të ndajnë perceptimet ndaj Maqedonisë, kryesisht nga trajtimi jo i drejtë i komunitetit Shqiptar në Maqedoni, afera e përgjimeve që shfaq një diskurs negativ ndaj Shqiptarëve, dhe përleshjet në Kumanovë në Maj të vitit 2015. Këto veprime janë listuar si faktorët kryesorë prapa perceptimeve negative ndaj Maqedonisë siç është listuar mesatarisht nga rreth 20.0 për qind e respondentëve.


Ngjashëm me rastin e Maqedonisë, trendi i respondentëve që ndajnë qëndrime pozitive ndaj Malit të Zi është rritur në tre vitet e fundit. Përderisa, në vitin 2014, 32.3 për

qind e respondentëve e shihnin Malin e Zi nga një prizëm pozitiv, këto shifra u rritën në 37.1 për qind në vitin 2016. Përveç qasjes pozitive të vendosur atëherë kur Mali i Zi njohu Kosovën, faktorët tjerë prapa kësaj qasje pozitive besohen të jenë liria e lëvizjes, si dhe komuniteti etnik Shqiptarë që jëton në Mal të Zi.

Qasja negative dhe hezitimi për të ndarë opinionet ndaj Malit të Zi, në anën tjetër, i është atribuar eventeve të fundit politike që lidhen me demarkacionin e kufirit në mes të Kosovës dhe Malit të Zi. Negociatat në lidhje me demarkacionin e kufirit kanë filluar në vitin 2012, megjithatë, vetëm në vitin 2015, kur Komisioni Evropian paraqiti planin final bëri që publiku i gjerë në Kosovë të shprehë pakënaqësi të mëdha. Diskursi negativ politik dhe ndjenja e “humbjes së tokave” në kufirin me Malin e Zi rezultoi në protesta, debate politike dhe në fund stagnimin e gjithë këtij procesi.


Shumica do të pajtoheshin që çështja e demarkacionit është problem që i përket elitës së brendshme politike në Kosovë, kurse disa të tjerë do të fajsonin BE-në për presionin që i bën të dyja palëve – veçanërisht asaj Kosovare duke e përdorë atë si kusht për liberalizimin e vizave, andaj rezultatet tregojnë se ky debat nuk i ka ndikuar qëndrimet ndaj Malit të Zi si shtet. Disa madje e vlerësojnë neutralitetin dhe qasje me “ftohtësi” të qeverisë së Malit të Zi kundrejt kësaj çështje. Si e tillë, qasja negative ndaj Malit të Zi është ulur me 5.7 për qind nga vitit 2014 në 2016.

Figura 2: Trendet e Perceptimeve të Publikut ndaj Maqedonisë dhe Malit të Zi



Edhe pse nuk janë të përfshira në edicionet e kaluara të BKS-së, marrë parasysh rrethanat politike të krijuara në rajon, ekipi i QKSS-së ka matur edhe perceptimet ndaj Kroacisë dhe Bosnje e Hercegovinës. Rezultatet tregojnë se rreth 90.0 për qind e qytetarëve e perceptojnë Kroacinë si vend mik ndaj Kosovës, me disa që e konsiderojnë atë si partnerin më të madh strategjik – politik dhe ushtarak për Kosovën. Në rastin e Bosnje e Hercegovinës, rreth 60.0 për qind e shohin atë si neutral apo mik ndaj Kosovës, këto perceptime janë bazuar në të kaluarën e ndarë, veçanërisht në relacion me agresionin e përjetuar nga Serbia. Me disa që kanë përmendur edhe aspektin religjioz si faktorë prapa qasjes pozitive kryesisht me respekt që Federatës ku Boshnjakët janë kryesisht të koncentruar. Rreth 30.0 për qind kanë ndarë perceptime negative kur janë pyetur për Bosnje e Hercegovinën, kryesisht duke ju referuar influencës Serbe, mungesës së marrëdhënieve bilaterale, mos qarkullim të lirë të mallërave dhe personave si dhe refuzim total për të njohur gjithçka që reflekton shtetësinë e Kosovës.

Figura 3: Trendet e Perceptimeve Publike ndaj Kroacisë dhe Bosnjë e Hercegovinës



KAPITULLI II

2. TRENDET E PERCEPTIMEVE TË PUBLIKUT NDAJ FUQIVË TË MËDHA

Krahas shteteve fqinje të Kosovës, të anketuarit janë pyetur për të ndarë perceptimet e tyre rreth shteteve të tjera, përkatësisht fuqitë kryesore që kanë ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në procesin e shtetndërtimit të Kosovës dhe të ardhmen e saj. Ndërsa perceptimet ndaj vendeve fqinje kanë reflektuar një përzjerje të opinioneve politike, sociale dhe kulturore, nga ana tjetër, perceptimet ndaj fuqive të mëdha janë të bazuara kryesisht në qëndrimin e këtyre vendeve ndaj statusit politik dhe shtetësisë së Kosovës. Roli i medias nuk duhet të injorohet, pasi opinionet e të anketuarve rreth fuqive të mëdha në botë konsiderueshëm janë formuar nga mediat dhe diskursi i përgjithshëm publik. Siç do të shihet në seksionin e mëposhtëm, ka një dallim të qartë të perceptimeve ndaj shteteve perëndimore, duke përfshirë Turqinë, nga njëra anë, dhe Rusinë e Kinën, në anën tjetër. Përderisa shtetet perëndimore janë parë me një lente pozitive, ekziston një mungesë e entuziazmit ndaj Ruisë dhe Kinës, me përjashtim të vogël në rastin e respondentëve serbë të Kosovës.

2.1. Trendet e Perceptimeve të Publikut ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Gjermanisë

Rezultatet e BKS-së që nga fillimi i edicionit special mbi politikën e jashtme tregojnë një trend pozitiv ndaj ShBA-së dhe Gjermanisë, këto vende kanë qenë në krye të listës duke qenë të perceptuara si vendet më mike ndaj Kosovës. Rreth 90.0 për qind e respondentëve kanë ndarë perceptim pozitiv ndaj këtyre dy vendeve, kryesisht për mbështetjen politike të dhënë përgjatë luftës së vitit 1999, procesit të ndërtimit të paqes më pastaj, si dhe procesit të shtet-ndërtimit. Si i tillë, perceptimi ndaj këtyre shteteve shihet përtej çështjeve bilaterale, mirëpo të dyja janë parë si aleatë dhe shtete partnere në procesin e shtet-ndërtimit, marrëdhëniet Euro-Atlantike si dhe pozicionimin e Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Përderisa në rastin e ShBA-së, rezultatet e BKS-së vërtetojnë perceptimin se Kosova është vendi me pro-amerikan. Kur analizohen rezultatet e perceptimeve të qytetarëve ndaj ShBA-ve, qëndron një varg i gjatë i faktorëve që i kontribuojnë qasjes pozitive, kryesisht e bazuar në qasjen pro-aktive para ndërhyrjes ushtarake, si dhe mbështetja politike në 15 vitet e kaluara deri më sot. Mirëpo, një vështrim më i afërt i rezultateve të BKS-së të vitit 2016 tregon që perceptimet pozitive ndaj ShBA-vë kanë shënuar rënie


(prej 91.4 për qind në vitin 2015 në 85.9 për qind në vitin 2016) – me 5.5 për qind për të qenë më korrekt. Kjo rënie mund të shpjegohet me një skepticizëm të përgjithshëm ndaj aleatëve kryesorë – kryesisht për shkak të zgjedhjeve presidenciale në ShBA (pa siguria e lidhshpimit të ri).

Në rastin e Gjermanisë, në anën tjetër, trendet tregojnë se qytetarët e Kosovës e shohin Gjermaninë si aleatin kryesorë brenda Europës. Qartazi, politika e jashtme Gjermane ndaj Kosovës dhe Serbisë (kushtëzimit për anëtarësim në BE) ka kontribuar në këtë trend pozitiv. Një faktor tjetër kontribues që ka influencuar pikëpamjet pozitive ndaj Gjermanisë është Diaspora Kosovare në Gjermani dhe remitancat që sjellen nga Gjermania. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të ceket se politika “zero-tolerancë” e qeverisë Gjermane kundrejt azil kërkuesve politik nga Kosova përgjatë vitit 2015 nuk ka arritur të lëkund perceptimin pozitiv ndaj këtij shteti.

Ngjashëm me perceptimet ndaj ShBA-së, trendet e perceptimeve pozitive ndaj Gjermanisë kanë pësuar një rënie të lehtë (nga 91.9 për qind në vitin 2014 në 89.7 për qind në vitin 2016) – me 2.2 për qind. Kjo rënie mund të atribuohet në qasjen e përgjithshme të BE-së ndaj Kosovës, e cila mundet potencialisht të përkthehet në perceptimet ndaj Gjermanisë – si lider kryesorë në BE – veçanërisht në procesin e integritimeve në BE për Ballkanin perëndimor.

Trendet negative ndaj ShBA-së dhe Gjermanisë kryesisht i atribuohen respondentëve Serb që jetojnë në Kosovë. Të dhënat e mbledhura në terren janë indikatorë që pavarësisht perceptimeve të tyre pozitive për ShBA-në dhe Gjermaninë si shtete mike ndaj Kosovës, ata ende shprehin rezerva ndaj të dyjave shteteve.

Figura 4: Trendet e Perceptimeve Publike ndaj ShBA-së dhe Gjermanisë



2.2. Trendet e Perceptiemve të Publikut ndaj Mbretërisë së Bashkuar, Francës dhe Turqisë

Qëllimisht, perceptimet ndaj Mbretërisë së Bashkuar, Francës dhe Turqisë janë grupuar në një vend, ky rreshtim është bërë në bazë të rezultateve të nxjerra nga tre edicionet e kaluara të BKS-së, lloji i partneritetit siç shihet në sytë e respondentëve si dhe ngjashmërisë kur bie fjala në rënien e konsiderueshme të perceptimeve pozitive në vitin e kaluar, BKS 2016.

Mbretëria e Bashkuar ka gëzuar një perceptim shumë pozitiv nga respondentët Kosovar në tre vitet e kaluara. Saktësisht, 82.2 për qind e respondentëve kanë ndarë perceptime pozitive ndaj Mbretërisë së Bashkuar në vitin 2014, ky trend vazhdoi të rritet në vitin 2015 në 83.9. Faktorët kryesorë që qojnë në perceptim pozitiv ndaj Mbretërisë së Bashkuar i atribuohet mbështetjes së pranuar nga Mbretëria e Bashkuar gjatë luftës në linjë me ShBA-në, më vonë këto perceptime ndaj Mbretërisë së Bashkuar janë bazuar në mbështetjen e dhënë në rrugën e Kosovës drejt BE-së, dhe procesit të shtet-ndërtimit në përgjithësi. Megjithatë, ky trend ka shënuar rënie në vitin 2016 kur vetëm 75.9 për qind kanë ndarë perceptim pozitiv ndaj Mbretërisë së Bashkuar. Pa dyshim që kjo reflekton rënien e përgjithshme të besimit ndaj aleatëve, por gjithashtu reflekton vendimin që Mbretëria e Bashkuar të dalë nga BE-ja. Rezultati i referendumit në Mbretërinë e Bashkuar solli pasiguri në të gjithë Europën, respondentët kanë qenë disi të konfuzuar në rolin e Mbretërisë së Bashkuar në të ardhmen, pra duke shënuar një rritje të numrit të atyre që konsiderojnë Mbretërinë e Bashkuar si neutrale.


Në mesin e të gjitha shteteve të BE-së, Franca ka pranuar nivelin më të ulët të perceptimeve pozitive nga respondentët. Siç shihet në Figurën 4, perceptimi ndaj Francës ka lëvizur lehtësisht rreth linjës së 60.0 përqindëshit e atyre që e radhitin këtë vend si pozitiv ndaj Kosovës. Përqindja e atyre që kanë listuar qëndrimin e Francës ndaj Kosovës si pozitive ka lëvizur nga 62.4 për qind në vitin 2014, në 66.3 për qind në vitin 2015 – kështu duke shënuar edhe radhitjen me të lartë pozitive – edhe pse kjo shënoi zbritje në 59.5 për qind në vitin 2016. Është shënuar një rritje e lehtë e atyre që besojnë se Franca është neutral ndaj Kosovës. Përderisa, qasja pozitive mund të jetë e bazuar në mbështetjen gjatë luftës dhe pozicionimin e diplomacisë Franceze dhe periudhën e pas-shpjalles së pavarësisë, ende ekziston një grup i respondentëve që mbeten të pakënaqur kundrejt Francës për shkak të mos efijencës së trupave Franceze (pjesë e KFOR-it) që të parandalojnë ndarjen e Mitrovicës në vitin 1999. Të tjerët, ndërkaq, nuk e shohin Francën si partner relevant në procesin e integritimit në BE, apo të tjera ngjarje të ndërlidhura me pozicionimin ndërkombëtarë të Kosovës në përgjithësi.

Qëllimisht e lënë për fund, Turqia, partneri strategjik për Kosovën që është jashtë BE-së ka qenë i perceptuar gjerësisht nga një prizëm pozitiv nga respondentët në tre vitet e fundit. Ndryshe nga vendet e tjera, perceptimi pozitiv për të mund të jetë i bazuar në

vlera dhe karakteristika religjioze, por edhe në bashkëpunimin ekonomik në mes të Turqisë dhe Kosovës – kryesisht përmes investimeve Turke në Kosovë.

Rritja e mobilitetit në mes të Kosovës dhe Turqisë – një nga vendet e pakta ku Kosovarët mund të udhëtojnë lirshëm pa viza. Ngritja e volumit të bashkëpunimit tregtar në mes të dy vendet, dhe investimet nga kompanitë Turke – shifra këto që nuk janë më të larta se sa ato të BE-së – por i është dhënë shumë vëmendje nga mediet dhe ka qenë më i hapur, ka dhënë përshtypjen që Turqia është investitori më i madh në Kosovë. Trendi pozitiv kundrejt Turqisë ka qenë i përbërë nga 80.3 përqind në vitin 2014, për të vazhduar me 85.2 për qind – duke shënuar pikën më të lartë të perceptimeve pozitive ndaj këtij shteti. Megjithatë, ky trend ka shënuar një rënie të shpejtë në vitin 2016, me vetëm 74.2 për qind të atyre që besonin se Turqia ka një qasje pozitive ndaj Kosovës. Kjo rënie prej 11 për qind mund të shpjegohet përmes faktorëve që nxiten nga frika e supozuar e agjendës islamike të Turqisë në Kosovë dhe përhapjen e ideve ekstremiste fetare. Lirshëm mund të konkludojmë se disa raportime në medie lidhur me këtë temë ka gjasë ta kenë ndihmuar formësimin e këtij opinion. Në anën tjetër, koncensionin për aeroportin, posedimi i të drejtës për distribuim të energjisë elektrike si projektet më të mëdha që kanë përfshirë Partneritetin Publik dhe Privat kanë gjasë që kanë nxitur dyshime për afera korruptive që përfshijnë qeverinë e Kosovës në një anë, dhe pakënaqësinë me shërbimet e dhëna në anën tjetër.

Figure 5: Trendet e Percpetimeve të Publikut ndaj Mbretërisë së Bashkuar, Francës dhe Turqisë



2.3. Trendet e Perceptimeve të Publikut ndaj Ruisë dhe Kinës

Në mesin e të gjitha shteteve të përfshira në hulumtim, Rusia dhe Kina janë rreshtuar prapa Serbisë në sytë e respondentëve. Përderisa, fuqitë perëndimore dhe Turqia janë parë nga një perspektivë më pozitive, e njejtë nuk ndodhë edhe me Ruisinë dhe Kinën – të cilat janë perceptuar si negative ndaj Kosovës nga një përqindje e lartë e respondentëve. Është me rëndësi të theksohet se perceptimet ndaj këtyre dy vendeve dallojnë nga Shqiptarët e Kosovës të cilët i shohin ato si pengesa për shtetësinë e Kosovës, përderisa, respondentët Serb të Kosovës ndajnë perceptimet kryesisht pozitive, pikërisht për shkak të qasjes së këtyre vendeve ndaj pavarësisë së Kosovës.


Pavarësisht faktit që këto vende janë gjeografikisht larg nga Kosova, si dhe marrëdhëniet diplomatike janë inekzistente, perceptimet ndaj këtyre shteteve janë ndërtuar kryesisht në bazë të qasjes së tyre ndaj pavarësisë dhe statusit politik të Kosovës në arenën ndërkombëtare. Një përjashtim është bërë me rastin e Ruisisë, e cila është vlerësuar edhe në bazë të mbështetjes politike që i jep Serbisë si dhe ndikimi politik që ka ky shtet në Ballkan në përgjithësi.

Opinionet pozitive ndaj Ruisisë janë të reflektuara në mesin e respondentëve Serb në Kosovë që kanë marrë pjesë në hulumtim, ky trend pozitiv ka shënuar rritje për 3.0 për qind, kështu duke reflektuar prezencën Rusë sidomos në pjesën veriore të Kosovës. Është pikërisht mbështetja që i jep Serbisë – si dhe Serbëve që jetojnë në pjesën veriore të Kosovës – faktori kyç që qëndron prapa perceptimeve negative ndaj Ruisisë nga respondentët Shqiptarë, kryesisht nga 85.0 për qind të atyre që besojnë se Rusia është vend armik ndaj Kosovës. Duke qenë i perceptuar si aleati më i madh i Serbisë në arenën ndërkombëtare, Rusia është kualifikuar si “dora e Serbisë” e cila është përdorur kryesisht për të bllokuar anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare. Kjo gjithashtu është reflektuar edhe në tentimet që Kosova bën në aspiratat e saj për tu bërë shtet anëtarë i Organizatës së Kombeve të Bashkuara apo agjencionet e kësaj organizate; Rusia në këto raste është parë si mbështetës i pa-lëkundur i Serbisë, kështu duke e përdorur fuqinë e vetos si shtet i përhershëm i Këshillit të Sigurimit për të bllokuar çdo iniciativë që do ta mbështeste legjitimitetin ndërkombëtarë të Kosovës.

Ngjashëm, Kina ka qenë i perceptuar si vend armik ndaj Kosovës gjithashtu, mesatarisht 65.0 për qind e respondentëve kanë konsideruar qasjen e Kinës ndaj Kosovës si armiqësore. Kina, gjithashtu, është parë si një pengesë në arenën ndërkombëtare. Ngurrimi i Kinës për të njohur pavarësinë e Kosovës, dhe fuqia e saj për veto në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, ka ndikuar shumë opinionin e respondentëve ndaj Kinës.

Në përgjithësi, opinionet ndaj Kinës janë ndërtuar në bazë të influencës dhe pozitës të këtij vendi në OKB, dhe jo domosdoshmërisht në bazë të praktikës apo përvojave personale që kosovarët kanë me këtë shtet. Përkundër një mendimi të përgjithshëm negativ kundrejt Kinës, ajo ende renditet më mirë se Rusia, dhe kjo mund të shpjegohet nga dy faktorë. Së pari, Kina nuk është perceptuar si një mbështetës i patundur i Serbisë siç është Rusia. Së dyti, janë dinamika e lartë tregtare dhe komerciale në mes Kosovës dhe Kinës, dhe ka raportime se kosovarët ende mund të udhëtojnë për në Kinë për të bërë biznes, ndërsa ata nuk kanë asnjë shans për të vepruar kështu, kur është fjala për Rusinë.

Figura 6: Trendet e Perceptimeve të Publikut ndaj Rusisë dhe Kinës



KAPITULLI III

3. TRENDET E PERCEPTIMEVE TË PUBLIKUT NDAJ ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE DHE PERSPEKTIVA EURO-ATLANTIKE E KOSOVËS

Krahas me shtetet më relevante për Kosovën dhe fuqitë e mëdha globale, të anketuarit janë pyetur për të dhënë opinionin e tyre për organizatat ndërkombëtare në të cilat Kosova qartazi aspiron anëtarësimin. Prirja e përgjithshme e perceptimeve pozitive tregon se qëndrimet e qytetarëve janë në përputhje me aspiratat e qeverisë kur është fjala për anëtarësim në organizatat/strukturat më të rëndësishme trans-atlantike. Për më tepër, opinionet dhe perceptimet e dhëna në këtë seksion janë të ndikuara shumë nga misionet që këto organizata drejtojnë dhe përfaqësojnë në Kosovë, disa prej tyre ende të pranishme në Kosovë me misione aktive. Kjo mund të konsiderohet si pozitive për faktin se perceptimet janë të ndërtuara në bazë të eksperiencave personale, megjithatë, mund të jetë me rrezik sepse i gjithë perceptimi mund të bazohet vetëm në mision pa i pasur parasysh apo ditur detajet tjera apo pa parë një fotografi më të madhe.

3.1. Trendet e Perceptimeve të Publikut ndaj ndaj anëtarësimit të Kosovës në BE

Pasi që integrimi dhe anëtarësimi në BE përbën një nga shtyllat kryesore të politikës së jashtme të Kosovës, si e tillë ajo pasqyrohet në pothuajse çdo proces të politik-bërjes, dhe agjendën e përgjithshme të politikave në Kosovë që aspirojnë të jenë në përputhje me legjislationin dhe standardet e BE-së. Si pasojë, matja e perceptimeve ndaj procesit të integritimit në BE ka qenë një nga pyetjet kryesore në të gjitha edicionet e BKS-së. Andaj, qytetarëve të Kosovës i është kërkuar që të vlerësojnë qasjen e BE-së ndaj Kosovës në procesin e liberalizimit të vizave, dhe vullnetit politik brenda BE-së për të pranuar Kosovën si anëtare.


Me sa duket, qytetarët e Kosovës kanë ndarë perceptime pozitive në lidhje me procesin e integritimit në BE përgjatë tre viteve të kaluara të BKS-së duke treguar në mënyrë të qartë një nivel të madh të entuziazmit ndaj këtij procesi. Kjo qasje pozitive nuk është zbehur edhe pse, qasja pozitive ndaj BE-së në vendet e rajonit është ulur dukshëm në vendet e rajonit, si dhe deklarimet nga ana e BE-së në të cilat qartazi është shafqur hezitim kundrejt procesit të zgjerimit drejte shteteve të Ballkanit Perëndimor në përgjithësi. Përveç të tjerash, rezultatet tregojnë që pavarësisht perceptimit të përgjithshëm ndaj qasjes së padrejtë të BE-së kundrejt Kosovës – veçanërisht në procesin e liberal-

izimit të vizave – nga 60.0 për qind të respondentëve, perceptimi pozitiv ndaj BE-së ka shënuar një rritje të lehtë përgjatë viteve të kaluara.

Një trend dhe qasje pozitive ndaj procesit të integritimit në BE është treguar përgjatë viteve, me një rritje të lehtë prej 3.6 për qind në krahasim me vitin 2015. Mesatarisht, rreth 90.0 për qind e respondentëve besojnë dhe shprehin vullnert për të iu bashkuar BE-së pavarësisht faktit se është një qëllim “shumë i largët” për Kosovën duke pasur parasysh reformat dhe numrin e kushteve që duhet të plotësohen, si dhe faktin e shanseve të zbehta për shkak të mos-njohjes nga të gjitha shtetet e BE-së. Ky perceptim pozitiv duket se është bazuar edhe në vendimin pozitiv që ka dhënë Komisioni në lidhje me liberalizimin e vizave për Kosovën, një vendim që nuk e futi Kosovën në “listën e bardhë të Schengenit”, por nxiti optimizëm në mesin e qytetarëve. Përveç kësaj, Marrëveshja për Stabilizim Asocim, ka shënuar një pikë kthimi në rrugën e Kosovës drejt BE-së – ngaqë është kompromisi i parë që është arritur në mesin e vendeve që nuk e njohin Kosovën.

Në anën tjetër, mesatarisht rreth 8.0 për qind e respondentëve e kanë kundërshtuar anëtarësimin e Kosovës në BE duke konsideruar se para kërimit të anëtarësimit, Kosova duhet të arrijë pjekuri politike dhe stabilitet të brendshëm, ose thjeshtë të shoh partnerë të tjerë strategjik jashtë BE-së.

Figure 7: Trendet e Perceptimeve të Publikut ndaj anëtarësimit të Kosovës në BE



3.2. Trendet e Perceptimeve të Publikut ndaj Anëtarësimit në NATO

Në përputhshmëri me agjendën euro-atlantike dhe aspiratave shtetërore për t’u bërë pjesë e NATO-s, respondentët janë pyetur nëse Kosova duhet të anëtarësohet në NATO. Pa dyshim, NATO gëzon një nivel të shëndoshë të besimit në mesin e qytetarëve të Kosovës kryesisht në bazë të ndërhyrjes ushtarake gjatë luftës në vitin 1999. Opinionet janë formësuar më tej edhe nga prezenca e KFOR-it në Kosovë. Marrë parasysh këto, ekziston një trend i perceptimeve pozitive ndaj anëtarësimit të Kosovës në NATO.


Një shumicë dërrmuese e të anketuarve ose 89.0 për qind mendojnë se Kosova duhet të bëhet anëtare e NATO-s. Përkundër qasjes neutrale të NATO-s ndaj Kosovës dhe mungesës së marrëdhënieve zyrtare me Kosovën, dëshira për t'u bërë pjesë e kësaj strukture është mjaft e lartë. Për më tepër, anëtarësimi në NATO duket të jetë i lidhur me aspiratën për të poseduar një forcë solide të armatosur që do të punojë së bashku me anëtarët e tjerë të NATO-s në arenën ndërkombëtare.

Trendet e perceptimeve ndaj anëtarësimit në NATO – siç shihen në figurën 7 – ka mbetur shumë solid, me një ngritje të lehtë në aspektin pozitiv. Ky qëndrim i njëtrajtshëm mund të shpjegohet nga fakti se shumica e respondentëve besojnë se prezenca e KFOR-it në Kosovë reflekton lidhjen e fortë në mes të Kosovës dhe NATO-s, si dhe do të sjellë anëtarësim në NATO në të ardhmen. Megjithatë, informacioni i mledhur përmes hulumtuesve në terren tregon se një shumicë dërrmuese e respondentëve kanë njohuri të limituara mbi strukturën dhe funksionimin e aleancës, si dhe procesin e vendim-marrjes politike që limiton marrëdhëniet kontraktuale dhe formale në mes të Kosovës dhe NATO-s – kryesisht për shkak të qëndrimit të shteteve mos-njohëse ndaj Kosovës.

Pavarësisht qasjes neutrale të NATO-s ndaj Kosovës dhe mungesa e marrëdhënieve formale me Kosovën, dëshira për t'u bërë pjesë e kësaj strukture mbetet shumë e lartë. Kjo mund të jetë pjesërisht e ndërlidhur me dëshirën për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forcë të Armatosur të Kosovës, një proces që do të kompletonte arkitekturën e sektorit të sigurisë dhe procesin e shtet-ndërtimit në Kosovë. Për më tepër, aleanca është parë si partneri i vetëm strategjik në sektorin e sigurisë, si e tillë, bërja pjesë e NATO-s do të nënkuptonte rreshtimin në mesin e Shqipërisë, Kroacisë dhe së shpejti Malit të Zi.

Në anën tjetër, rreth 9.0 për qind e respondentëve mesatarisht kanë kundërshtuar fuqishëm anëtarësimin në NATO; kjo qasje negative është prezente kryesisht në mesin e respondentëve Serb të cilët fuqimisht e kundërshtojnë anëtarësimin e Kosovës në NATO. Kjo mund të shpjegohet nga fakti se respondentët Serb kundërshtojnë NATO-n, kështu duke qëndruar në linjë me politikën e Beogradit, përderisa, qartazi duke treguar preferencë ndaj përforcimit të partneritetit me Rusinë në sektorin e mbrojtjes.

Figure 8: Trendet e Perceptimeve të Publikut ndaj anëtarësimit në NATO



KAPITULLI IV

4.1. TRENDET E PERCEPTIMEVE TË PUBLIKUT NDAJ DIALOGUT POLITIK ME SERBINË

Gati një dekadë pas fillimit të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, si në nivelin teknik dhe politik, ky proces afatgjatë dhe i vështirë ka nxitur shumë debate të nxehta në mesin e elitës politike në Kosovë dhe qytetarët e Kosovës. Dy edicionet e para të KSB-së janë fokusuar në pyetjet se a duhet Kosova të vazhdojë dialogun me Serbinë, nëse Kosova duhet të ndryshojë pozicionin, e saj më tutje. Shumë dyshime në lidhje me procesin u ngritën nga këndvështrime të ndryshme nga të dyja palët, Shqiptarët dhe Serbët e Kosovës. Megjithatë, në këtë pikë, dialogu është një realitet politik dhe proces i pakthyeshëm, dhe çdo tërheqje e mundshme nga ky proces mund të prodhojë pasoja të mëdha politike në rrugën e të dyja vendeve drejt BE-së.

Pyetja nëse normalizimi është me të vërtetë duke ndodhur, ose nëse thjesht duke u shtyer artificialisht nga elitat politike me qëllim të “mashtimit” të liderëve të BE-së, si mënyre e lehtë për të fituar përparësi në rrugën e tyre drejt BE-së. Çështja tjetër tejet e diskutueshme është në lidhje me fituesin e vërtetë të këtij procesi, nëse Kosova apo Serbia po përfiton më shumë nga dialogu, ka shkaktuar shumë debate në mesin e opinionit publik në të dy vendet.

Debati mbi përfitimet nga ky dialog ka shkaktuar ndarje të mëdha në mes të qeverisë dhe opozitës në Kosovë, duke shkaktuar kështu shumë debate, filluar nga çështjet që duhet të diskutohen, agjendën e Qeverisë së Kosovës në lidhje me këtë proces, si dhe të mundësisë së ri-formatimi të dialogut. Pakica serbe e Kosovës, në anën tjetër, e percepton dialogun si një proces pozitiv, duke pritur që ajo të përmirësojë jetën e tyre në Kosovë - edhe pse duke kundërshtuar të zbatojë marrëveshjet e nënshkruara në Bruksel. Nga ana tjetër, dialogu po konsiderohet si një proces i kushtueshëm duke pasur parasysh se përfaqëson një hap përpara në njohjen e shtetësisë së Kosovës nga ana e Serbisë - sipas perceptimit të tyre.

4.2. (Mos) arritja e normalizimit

Nëse dialogu është konsideruar si një sukses apo dështim kryesisht varet nga pritjet e njerëzve si dhe interpretimi nga të dyja palët. Megjithatë, për shkak të mungesës së transparencës përgjatë gjithë procesit, kryesisht mbi marrëveshjet e arritura në mes të

dy palëve, si dhe gjuha tejet diplomatike në tekstet e marrëveshjeve kanë lënë boshllëqe të mjaftueshme që të dyja palët të i interpretojnë marrëveshjet ndryshe.


Kur janë pyetur nëse dialogu ka kontribuar në normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, trendet tregojnë se gjysma e të anketuarve - rreth 50.0 për qind mesatarisht - besojnë se dialogu po dështon për të arritur qëllimin gjithëpërfshirës - normalizimin e vërtetë të marrëdhënieve mes të Kosovës dhe Serbisë. Gjysma e të anketuarve janë pesimistë në këtë drejtim, duke besuar se situata nuk ka ndryshuar nga para fillimit të dialogut, dhe se marrëdhëniet nuk janë normalizuar aspak. Pjesa më e madhe e të anketuarve besojnë se dialogu është një proces politik i shkëputur nga realiteti në Kosovë; prandaj ka dështuar për të siguruar progres në jetën e qytetarëve, si për shqiptarët e Kosovës, poashtu edhe për serbët e Kosovës.

Ky skepticizëm ndaj dialogut i ka rrënjët në dështimin për të parë një politikë të Serbisë më të butë ndaj Kosovës, kryesisht në lidhje me pozicionimin e Kosovës në arenën rajonale dhe ndërkombëtare, mungesa e vullnetit politik për të zbatuar marrëveshjet e arritura në Bruksel - disa të dështuara pikërisht për shkak të rezistencës së lartë nga Serbia për të krijuar një mjedis të favorshëm për zbatim më të mirë të marrëveshjeve. Nga ana tjetër, në sytë e të anketuarve serbë, dështimi për të arritur një konsensus politik mbi Asociacionin e Komunave Serbe në Kosovë ka kontribuar në masë të madhe në rritjen e skepticizmit ndaj këtij procesi.

Trendet e perceptimit në mesin e atyre që besojnë se marrëdhëniet janë normalizuar disi në mes të Kosovës dhe Serbisë janë rritur pak. Ndërsa në vitin 2014, 46.0 për qind e qytetarëve besonin se ka pasur një lëvizje pozitive drejt normalizimit, ky numër ka rënë në 37.7 për qind në vitin 2015 - kur ndeshja e futbollit në mes të Shqipërisë dhe Serbisë ka ngjallur debate serioze mbi identitetet kombëtare në Ballkan. Në vitin 2016, kjo situatë duket se është neutralizuar pak, nga 44.1 për qind e atyre që besojnë se normalizimi është duke ndodhur, edhe pse kjo qasje ishte relevante në Tetor kur u zhvillua hulumtimi në terren, së fundmi diskursi agresiv i politikës së Serbisë ndaj Kosovës - muri i ndërtuar në Mitrovicë i cili e ndan qytetin në baza etnike, do të influenconin së tepërmi perceptimin e të anketuarve.

Në anën tjetër, një numër i vogël i të anketuarve, ose rreth 5.0 për qind në mesatare ka deklaruar se marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë janë normalizuar. Ky perceptim është justifikuar nga rritja e mobilitetit për shkak të marrëveshjes për lirinë e lëvizjes së qytetarëve - megjithëse me disa kufizime nga ana serbe, kryesisht në tabelat e regjistrimit të makinave të kosovarëve.

Figura 9: Trendet e Perceptimeve të Publikut ndaj Normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë



4.3. Dialogu Politik në mes të Kosovës dhe Serbisë: Kush është fituesi?

Pothuajse të gjitha marrëveshjet që janë arritur në mes të Kosovës dhe Serbisë kanë qenë të interpretuara ndryshe nga palët e përfshira në proces, çdo periudhë e pas-marrëveshjeve është manifestuar nga tre interpretime të ndryshme të marrëveshjes së arritur në Bruksel, një në anën e Kosovës, një në atë serbe – secila duke renditur veten si fituese - ndërsa gjuha tepër diplomatike nga ana e BE-së ka shërbyer si një mjet për të zbutur perceptimet negative të krijuara në të dyja anët. Mungesa e transparencës gjatë gjithë procesit, dhe vendimmarrja pas “dyerve të mbyllura”, kanë krijuar hapsirë për keqinterpretim, keqpërdorim të përmbajtjes së marrëveshjeve nga ana e elitave politike në të dy vendet, si dhe ka penguar në shumë aspekte të zbatimit dhe ndikimit të mundshëm të këtyre marrëveshjeve në jetën e qytetarëve. Përgjigjet e dhëna kur janë pyetur në lidhje me fituesin e mundshëm të dialogut variojnë nga interpretimi dhe pozicionimi i responentit. Debatimi gjatë me qëllim për të kuptuar nëse ky proces do të rezultojë në një situatë ku të dyja palët do të fitojnë - që do të thotë të dy vendet kanë arritur qëllimin gjithëpërfshirës, anëtarësimin në BE - rrethanat e krijuara pas gjashtë viteve të dialogut lënë hapsirë për interpretime të ndryshme.


Kur u pyetën se kush po përfiton shumë nga dialogu Kosova apo Serbia, pothuajse gjysma e të anketuarve, ose 45.3 për qind e tyre kanë besuar se Serbia po përfiton më shumë se Kosova në vitin 2015, i njëjti trend ka vazhduar në vitin 2016 me një rritje të lehtë në 46.4 që besonin kështu. Shumica e argumenteve të përdorura nga të anketuarit ishin të ndërlidhura me rrugën e përshpejtuar të Serbisë drejt BE-së, ndërsa në të njëjtën kohë Kosova ka shënuar stagnim, si dhe numri i madh i përfitimeve që

Serbia ka nxjerrë vazhdimisht nga ky proces. Me Kosovën që ka mbetur jashtë regjimit pa viza të BE-së, dhe Serbia, në anën tjetër, që ka bërë hapjen e kapitujve kryesorë në procesin e anëtarësimit në BE, ka bërë që të anketuarit shqiptarë të Kosovës të besojnë se Kosova po bëhet "trampolinë" e Serbisë në rrugën e saj drejt anëtarësimit në BE. Roli udhëheqës i Serbisë në rajon ka krijuar perceptimin se ka një diskrepancë në qëndrimin e BE-së ndaj Serbisë dhe Kosovës.

Nga ana tjetër, vetëm 12.7 përqind e të anketuarve besojnë se Kosova është duke përfitur më shumë se Serbia në këtë proces, ky trend ka shënuar një rritje të lehtë në 14.8 për qind e atyre që mendojnë kështu. Faktorët prapa qëndrimeve të tilla janë të ndërlidhura kryesisht me MSA-në, duke besuar se ajo shënon marrëveshjen e parë kontraktuale në mes të Kosovës dhe BE-së, si një marrëveshje historike në rrugën e Kosovës drejt BE-së. Përveç kësaj, shumica e të anketuarve që besojnë se Kosova është duke përfitur më shumë se Serbia deklaroi se dialogu në fund do të rezultojë me njohjen e pavarësisë së Kosovës nga autoritetet serbe. Kjo është problematike, sepse kjo tregon se edhe kjo përqindje e vogël e njerëzve që besojnë se Kosova është duke përfitur më shumë se Serbinë, lehtë mund të zhvendosë mendimin e tyre në drejtim të kundërt, kur bëhet e qartë se procesi në të vërtetë nuk çon në drejtim të asaj që ata janë duke shpresuar - një shans shumë i vogël që kjo të ndodhë në të ardhmen e afërt. Nga ana tjetër, ky opinion pozitiv mund të forcohet edhe më tej në të ardhmen në varësi të përmbajtjes së kapitullit 35 të negociatave për anëtarësim në BE-së me Serbinë, e cila kryesisht ka të bëjë me normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën para se të anëtarësohet në BE. Ky proces është, megjithatë, shumë i gjatë për të mbajtur një opinion të tillë pozitiv terren.

Në anën tjetër, gjatë vitit 2015 më pak se një e katërta e të anketuarve ose 22,6 për qind e tyre kishin besuar se dialogu po i sjell përfitime të dyja palëve Kosovës dhe Serbisë, dhe që të dy po përfitojnë në mënyrë të barabartë duke shënuar progres në procesin e integritimit në BE. Ky perceptim ka pësuar një rënie të lehtë në vitin 2016 me 16.9 për qind që besonin se dialogu do të përfundojë si fitore për të dyja palët, dhe se ky proces është duke u përdorur nga BE-ja me qëllim për të fituar kohë dhe për të mbajtur stabilitetin në rajon. Duke pasur parasysh këtë, grupi i të anketuarve që besojnë se dialogu është një lojë me zero përfitime ka shënuar një rritje prej 15.7 për qind në vitin 2015 në 19.0 për qind në vitin 2016. Ky grup i të anketuarve beson se të dyja palët janë duke sakrifikuar shumë dhe se rezultati e këtij dialogu do të çojë askund.

Figura 10: Trendet e Perceptimeve të Publikut për rezultatit të Dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë



4.4. Trendet e Perceptimeve të publikut për krijimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe

Marrëveshja për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe (AKS) u arrit dhe nënshkrua nga autoritetet Kosovare dhe Serbe në Gusht të vitit 2015, si pjesë e dialogut Kosovë-Serbi në Bruksel (Komisioni, 2015).


Nuk ka kaluar kohë të gjatë para se të arrihet kulmi i debateve të nxehta politike mes qeverisë dhe opozitës në Kosovë mbi përmbajtjen e marrëveshjes. Si pasojë, kjo marrëveshje u bë një nga arsyt kryesore që çuan në krizën politike në Kosovë dhe rritjes së pakënaqësisë ndaj Qeverisë në Kosovë, përfitimet nga bisedimet, dhe të ardhmen e shtetit multi-etnik krijuar në vitin 2008.

Në përgjithësi, gjetjet pasqyrojnë situatën politike në Kosovë; një shumicë e madhe e të anketuarve, ose 71.7 për qind e tyre kanë ndarë qëndrim negativ sa i përket theme-limit të AKS duke e parë atë të dëmshme për Kosovën në vitin 2015, ky trend negativ ka vazhduar të rritet në 78.0 për qind të atyre që besojnë kështu. Vlen të përmendet se finalizimi i marrëveshjeve dhe detajet e publikuara të përmbajtjes së saj ka zemëruar respondentët Shqiptar në Kosovë. Përveç kësaj, ngritja e vetëdijes për këtë çështje, duke qenë çështja më e diskutuar në media dhe në mesin e politikanëve, ka kontribuar në një rritje të trendit negativ me rreth 15.0 për qind në krahasim me rezultatet e nxjerra në vitin 2014. Vlen të përmendet se ky diskurs, mungesa e transparencës dhe pasiguria në këtë proces është një nga faktorët kryesor pse qytetarët e Kosovës e kanë vlerësuar këtë çështje me inercion, dhe jo bazuar në përmbajtjen e marrëveshjes. Për më tepër, vazhdimi i këtij debati dhe mungesa e konsensusit politik në anën kosovare ka nxitur edhe më tej perceptimin negativ ndaj kësaj marrëveshjeje. Nga ana tjetër,

presioni i ushtruar nga Serbia – elita politike e Beogradit – është intensifikuar kohët e fundit, edhe duke kërcënuar me një ultimatum për autoritetet kosovare, përndryshe asociacioni do të krijohet në mënyrë të njëanshme vetëm nga pala serbe.

Nga ana tjetër, perceptimi i balancuar ndaj AKS nga 17.9 për qind në vitin 2014 ka shënuar rënie të vazhdueshme përgjatë viteve, me konkretisht në 16.2 për qind në vitin 2015 dhe 11.5 për qind në vitin 2016. Ndërsa vetëm rreth 8.0 për qind besojnë se zbatimi i kësaj marrëveshje është pozitiv. Nga hulumtimi cilësor në terren i të anketuarve, del se serbët e Kosovës në përgjithësi ndajnë pikëpamjet pozitive, ndërsa shqiptarët besojnë se krijimi i AKS cenon rëndë rendin kushtetues të Kosovës dhe stabilitetin e vnedit. Ekziston frika se AKS nuk nxit krijimin e një shoqërie multi-etnike - siç thuhet në kushtetutë, por do të kontribuojë më tepër në krijimin e një shoqëri të ndarë etnikisht. Për më tepër, perceptimi negativ nuk rrjedhë nga frika se AKS do të japë të drejta shtesë për minoritetin serb, por nga frika se ajo do të shërbejë si një mjet kundër shumicës. Në përgjithësi, rreth 7.0 për qind mesatarisht në tre vitet e fundit, nga të gjitha etnitë nuk kanë dashur të përgjigjen dhe nuk kishte asnjë informacion mbi këtë çështje.

Figura 11: Trendet e Perceptimeve të publikut për krijimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe



Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

351.746.1(496.51)(048)

327(497.11:496.51)(048)

Barometri kosovar i sigurisë : edicion special : trendet e perceptimeve të publikut për politikën e jashtme dhe dialogun me Serbinë : periudha 2013-2016 / Interpretues i të dhënave Donika Emini. - Prishtinë : Qendra e Kosovare për Studime të Sigurisë, 2017. - 32 f. : ilstr. me ngjura ; 21 cm.

1.Emini, Donika

ISBN 978-9951-679-58-9

ISBN 978-9951-679-58-9



9 789951 679589

www.qkss.org